



# **PËRFSHIRJA E BARAZISË GJINORE DHE SOCIALE (BGJS)**

**në Grantin e Performancës Komunale (GPK)**

**PËRFSHIRJA E BARAZISË  
GJINORE DHE SOCIALE (BGJS)  
NË GRANTIN E PERFORMANCËS  
KOMUNALE (GPK)**

---

Ky raport është përgatitur nga Kosovo Democratic Institute (KDI) për projektin e SDC-së – DEMOS, bashkëfinancuar nga Suedia dhe Norvegjia, implementuar nga HELVETAS Swiss Intercooperation-Kosovo.

**Mohim:** Gjetjet dhe konkluzionet e shprehura në këtë raport nuk paraqesin domosdoshmërisht qëndrimet e SDC-së, Suedisë, Norvegjisë dhe HELVETAS Swiss Intercooperation.

---

©DEMOS

Publikuar: mars 2021

Prishtinë, Kosova

# Tabela e përmbajtjes

<b>Metodologjia</b> .....	<b>5</b>
Qëllimi i hulumtimit: .....	5
<b>Gjetjet</b> .....	<b>7</b>
<b>Marrja parasysh dhe adresimi i nevojave dhe kërkesave të grupeve të marginalizuara/të cenueshme gjatë planifikimit të projekteve kapitale komunale</b> .....	<b>9</b>
Dizajnimi dhe planifikimi i projekteve kapitale komunale .....	11
Grumbullimi i nevojave/kërkesave të grupeve të marginalizuara / të cenueshme nga komuna.....	12
Përpjekjet e veçanta të komunave për t'i arritur grupet e marginalizuara/ të cenueshme gjatë planifikimit të buxhetit .....	13
Shpenzimet buxhetore për secilin grup të marginalizuar .....	13
<b>Projektet kapitale të financuara përmes GPK-së, pjesë e prioriteteve ose listës rezervë</b> .....	<b>15</b>
<b>Përfitimet që grupet e marginalizuara gëzojnë nga projektet kapitale komunale të zbatuara në komuna</b> .....	<b>16</b>
Përmbledhje .....	16
Istogu .....	16
Kaçanik .....	18
Lipjan.....	19
Novobërdë.....	21
Podujevë .....	22
Shtërpçë.....	24
Shtime .....	25
Vushtrri.....	26
Kush është lënë pas?.....	28
<b>Zbatimi i dëgjimeve buxhetore nga komunat dhe pjesëmarrja nga qytetarët</b> .....	<b>28</b>
<b>Zbatimi i buxhetimit të përgjegjshëm gjinor nga komunat dhe mënyra si e bëjnë atë</b> .....	<b>30</b>
<b>Pjesëmarrja e qytetarëve në proceset e politikbërjes dhe vendimmarrjes në komuna</b> .....	<b>32</b>
<b>Rekomandimet</b> .....	<b>34</b>



## Qëllimi i hulumtimit

Së bashku me DEMOS-in, tetë komuna janë përzgjedhur sipas madhësisë së mostrës, për të realizuar vlerësimin e Barazisë Gjinore dhe Sociale (BGjS) në Grantin e Performancës Komunale (GPK). Tetë komuna të cilat ishin pjesë e 25 komunave të kualifikuara në vitin 2018 dhe 19 komunave në vitin 2019, u përzgjedhën për vlerësim. Mostra prej tetë komunave përfshin dy komuna me shumicë Serbe, si Novobërda dhe Shtërpca. Këto komuna kanë përfutuar nga GPK-ja, përmes të cilës kohëve të fundit janë financuar projekte të caktuara kapitale. Sa i përket kornizës kohore, projektet e financuara në vitin 2018 dhe 2019 janë përzgjedhur për vlerësim ose rishikim. Sa i përket numrit të projekteve që përbëjnë madhësinë e mostrës, 12 projekte kapitale të financuara përmes GPK-së në tetë komuna janë përzgjedhur së bashku me DEMOS-in. Këto 12 projekte janë përzgjedhur në mesin e 50 projekteve të financuara nga GPK-ja në vitin 2018 dhe 36 në vitin 2019, dhe ndërlidhen me projektet që janë financuar gjithashtu nga pjesa e fondeve të MAPL-së. Komunitet e përmendura në vijim u vlerësuan dhe vizituan:

Nr.	Komuna	Nr. i projekteve	Projekti
1	Istog	1	Rregullimi i hapësirës dhe infrastrukturës përreth sallës së sporteve
2	Kaçanik	2	Rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve të qytetit Ndërtimi i trotuareve në lagjen Imisht
3	Lipjan	1	Vendosja e pajisjeve sinjalizuese në qytetin e Lipjanit
4	Novobërdë	1	Rregullimi i stadiumit të futbollit në fshatin Prekovic
5	Podujevë	2	Ndërtimi i ambulants në fshatin Majac Ndërtimi i shtëpive për rastet me asistencë sociale në "Lagjen e Dëshmorëve" në Balloc
6	Shtime	1	Rregullimi i trotuareve, ndriçimit publik dhe hapësirave të gjelbra në rrugët "Komandant Kumanova" (pjesa e mbetur), "Tahir Sinani", "Anton Çeta" dhe të hapësirës për parking tek shkolla "Emin Duraku"
7	Shtërpce	2	Rindërtimi i ndriçimit publik, vendosja e teknologjisë LED në fshatin Firajë Ndërtimi i kanaleve të prej betoni në Shtërpce
8	Vushtrri	2	Ndërtimi i terrenit për stërvitje në stadiumin e futbollit në Dobërlukë Rindërtimi i hapësirave në sheshe në Stanoc i Poshtëm, Novolan Maxhunaj, Bukosh, Nedakoc, Druar, Banjskë, Studime e Poshtme, Stanoc i Epërm dhe në qytetin e Vushtrrisë (12 projekte)
		12	

Për qëllime të vlerësimit janë zbatuar metodat në vijim: dizajnimi i tre llojeve të pyetësorëve për tre grupe të synuara: 1) zyrtarët komunalë nga drejtoritë e buxhetit dhe financave, shërbimet publike, zyrat gjinore, zyrat për çështje të komunitetit, zyrtarët e projektit dhe përfaqësuesit e zyrave të Handikos në tetë komuna, 2) OJQ-të lokale të cilat janë aktive në tetë komuna dhe merren me grupet e marginalizuara në një formë ose tjetër, dhe 3) grupet e marginalizuara. Përkufizimi i grupeve të marginalizuara/të cenueshme që e ka bërë DEMOS-i ka shërbyer për të përcaktuar grupet përkatëse të marginalizuara. Ata janë: Personat me nevoja të veçanta, komunitetet Romë, Ashkali dhe Egjiptianë, të rinjtë (gra/burra të rinj), gratë, pensionistët/të moshuarit, banorët në zona rurale/të largëta, dhe komunitetet jo shumicë. Sa i përket pyetësorëve, DEMOS-i u dakordua për to, dhe më pas u transferuan në internet (online) dhe u shpërndanë tek grupet e synuara, përveç grupeve të marginalizuara. Këta të fundit u intervistuan kryesisht me anë të intervistave telefonike, duke e aplikuar llojin e tretë të pyetësorit i cili u është kushtuar grupeve të marginalizuara/të cenueshme.

Përveç pyetësorëve online, në komunat përkatëse ka pasur edhe takime të drejtpërdrejta me zyrtarë komunalë, dhe në shumicën e rasteve me OJQ-të lokale. Pas intervistave sy më sy, janë kryer gjithashtu edhe vizita me zyrtarët e projekteve të komunave përkatëse në vendet ku janë zbatuar (ose janë duke u zbatuar) projektet. 49 intervista u realizuan në total me tre grupet e synuara. Këto intervista u realizuan për t'i parë përfitimet që grupet e marginalizuara/të cenueshme i kishin nga projektet kapitale të zbatuara, dhe për të parë nëse këto projekte kanë përmirësuar jetën e grupeve të marginalizuara/të cenueshme në komunë. Në dakordim me DEMOS-in, në ato komuna ku ishin përzgjedhur dy projekte për vlerësim, vizitat u realizuan vetëm në njërin projekt, por diskutimet për tjetrin projekt nuk u ndalën.

Përveç atyre elementeve që u përmendën më sipër, edhe katër elemente të tjera u investiguan: a) zbatimi i dëgjimeve buxhetore në komunat në fjalë, b) zbatimi i buxhetimit të përgjegjshëm gjinor (BPGj), c) pjesëmarrja e qytetarëve në proceset e politikbërjes dhe vendimmarrjes në komunë dhe, d) qasja "mos lini askënd pas" (ang. leave no one behind).

Qasja "mos lini askënd pas" u zbatua përgjatë hulumtimit, ku secila komunë u pyet mbi pesë faktorë, në mënyrë që t'i japin arsytet se pse nuk u morën parasysh nevojat dhe kërkesat e komunave gjatë planifikimit dhe hartimit të projekteve kapitale komunale. Këto pesë faktorë janë: 1) diskriminimi, 2) statusi socio-ekonomik, 3) gjeografia (distanca), 4) qeverisja komunale dhe 5) mungesa e përfaqësimit dhe pjesëmarrjes. Faktori i parë ka të bëjë me arsytet diskriminuese se pse nuk merren parasysh nevojat/kërkesat e grupeve të marginalizuara, kurse faktori i dytë ndërlidhet me të parin dhe tenton të shpjegojë nëse nevojat nuk merren parasysh për shkak të statusit socio-ekonomik që këto grupe e kanë. Faktori i tretë ka të bëjë me gjeografinë, domethënë për të parë nëse distanca ndërmjet grupeve të marginalizuara (për shembull banorët në zona rurale/të largëta) dhe komunës është faktor që jep arsyen se pse nuk merren parasysh nevojat e tyre nga komuna. Faktori i katërt ka të bëjë me cilësinë e qeverisjes, domethënë për të parë nëse qeverisja komunale është e dobët për të marrë parasysh dhe adresuar nevojat e këtyre grupeve. Faktori i pestë ka të bëjë me mungesën e përfaqësimit të grupeve të marginalizuara/ të cenueshme në organet komunale, si arsye se pse komuna nuk po i merr parasysh grupet e marginalizuara/të cenueshme. Rezultatet e nxjerra nga këto pyetje më tetë komuna janë dhënë në seksionin përkatës të raportit.

1. Komunat e vlerësuara nuk kanë bërë hartëzim të shqetësimeve të grupeve të marginalizuara/të cenueshme në komunë, dhe rrjedhimisht nuk i dinë nevojat dhe kërkesat e tyre, përveç rasteve ku ka pasur kërkesa individuale nga këto grupe;
2. Në mënyrë të ngjashme, asnjë nga komunat e vlerësuara nuk ka identifikuar asnjë grup të marginalizuar/të cenueshëm ku nevojiten shërbime/burime/projekte shtesë. Në anën tjetër, pesë nga tetë komunat e vlerësuara kanë deklaruar që përparësi u jepet personave me nevoja të veçanta (shih më poshtë për informacionet për komunat specifike);
3. Grupet e marginalizuara/të cenueshme i shprehen shumicën e nevojave dhe kërkesave të tyre me anë të grupeve përkatëse përmes kërkesave individuale. Kështu funksionon në shumicën e rasteve në komunat e vlerësuara;
4. Prandaj, komunat e gjejnë veten duke mbështetur projekte pa vizion/plan që ju garanton qëndrueshmëri, dhe për këtë arsye kanë gjasa që t'i financojnë çdo vit gati se të njëjtat projekte. Ky proces i përzgjedhjes së projekteve për financim nuk ka dëshmuar të jetë i qëndrueshëm, i planifikuar dhe që çon në përmirësimin e situatës së grupeve të marginalizuara/të cenueshme;
5. Edhe komunat edhe grupet e marginalizuara/të cenueshme deklarojnë që nevojat/kërkesat e grupeve të marginalizuara merren parasysh në masë të madhe përmes kërkesave individuale, megjithatë, adresimi i nevojave të tyre është sporadik, jo i programuar dhe në baza të atypëratyshme (ad-hoc). Gjithashtu mungon planifikim i mëhershëm për mbështetjen e këtyre grupeve;
6. Mbështetja financiare e propozimeve të projekteve nga komunat për grupet e marginalizuara/të cenueshme është e drejtuar në masë të madhe drejt organizatave përfaqësuese të grupeve të tilla. Për shembull, nëse komuna e mbështet zyrën e Handikos në baza vjetore të themi me 12,000 euro, ata konsiderojnë që i kanë shqyrtuar dhe adresuar plotësisht nevojat/kërkesat e personave me nevoja të veçanta. Bazuar në bisedimet e kryera me grupet e marginalizuara/të cenueshme, kjo gjë është dëshmuar që nuk qëndron. Për shembull, në Kaçanik, nevojat e personave me nevoja të veçanta në raste individuale kanë qenë të ndryshme me ato nevoja/kërkesa që zyra e Handikos i ka pasur në këtë komunë. Kjo nënkupton që financimi i një organizate përfaqësuese nuk është e njëjtë me mbështetjen e nevojave/kërkesave të të gjithë grupit;
7. Komunat e vlerësuara nuk kanë arritur të sjellin shembuj kur lista e projekteve kapitale që do të zbatohen në komunë ka ndryshuar për shkak të nevojave/kërkesave të grupeve të marginalizuara/të cenueshme. Në anën tjetër, sipas komunave, projektet për të cilat sigurohet bashkëfinancimi futen menjëherë në listën e prioriteteve, dhe sidomos ato projekte që bashkëfinancohen me donatorë ndërkombëtarë;

8. Kur u bë planifikimi dhe miratimi i listës së projekteve, asnjë komunë nuk ka deklaruar që do të merr parasysh nevojat/kërkesat e grupeve të marginalizuara gjatë zbatimit të projektit;
9. Sa i përket asaj se kush është lënë pas - arsyet pse dikush nga grupet është lënë pas (pesë faktorët) - shumica e komunave i janë referuar mungesës së përfaqësimit dhe pjesëmarrjes së grupeve të marginalizuara;
10. Sa i përket mënyrës se si komuna i mbledh nevojat/kërkesat e grupeve të marginalizuara/të cenueshme, kërkesat individuale dhe takimet publike kanë përparësi para formave të tjera të organizimeve ose eventeve;
11. Asnjë komunë nuk ka deklaruar që po bën ndonjë përpjekje të veçantë për të pasur kontakt me grupet e marginalizuara, përveç kur është koha e zgjedhjeve, ose kur këto evente organizohen nga donatorët;
12. Buxheti nuk klasifikohet përshatshmërisht me grupet e marginalizuara/të cenueshme. Në bazë të këtij fakti, propozimet e paraqitura nga grupe të tilla financohen në mënyrë të shpërndarë. Një projekt i caktuar mund të përzgjidhet të mbështetet nga një drejtori e caktuar, ose nga ndonjë drejtori tjetër, ose nga zyra e kryetarit të komunës - varësisht nga tema e projektit, për shembull një projekt propozim që ka të bëjë me arsimin, mbështetet nga drejtorja e arsimit, etj;
13. Tetë komunitet që i nënshtrohen këtij vlerësimi kanë Zyra për Çështje të Komunitetit, megjithatë, buxheti i tyre është shumë i kufizuar në kategorinë e subvencioneve nga ku mund të mbështeten projektet që kanë të bëjnë me komunitete;
14. Nga 12 projektet e përzgjedhura në tetë komuna, gjashtë prej tyre kanë qenë pjesë e listës prioritare dhe gjashtë të tjera kanë qenë pjesë e listës rezervë të projekteve kapitale;
15. Nga 12 projektet e vizituara, rinia është më së shpeshti përfitues i drejtpërdrejtë. Në fakt, rinia është përfitues i drejtpërdrejtë në tetë nga dymbëdhjetë projektet e vizituara;
16. Gjatë vizitave u vërejt se nuk janë përfunduar të gjitha projektet e financuara gjatë vitit 2018 dhe 2019. Për më tepër, gjatë vizitës në vend u vërejt se katër nga dymbëdhjetë projekte nuk kishin përfunduar;
17. Në rastin e Istogut, gjatë vizitës në fillim të nëntorit tek zona përreth sallës së sporteve, që u financua përmes GPK-së, u vërejt që ajo nuk kishte përfunduar akoma. E njëjtë ishte gjendja edhe në projektin për stadiumin e futbollit në komunën e Novobërdës, i cili as nuk ka përfunduar dhe as nuk ka filluar shfrytëzimi i tij akoma. Dy raste tjera të kësaj natyre janë vërejtur në Podujevë (projekti për ndërtimin e shtëpive për familjet që marrin asistencë sociale, në Ballofc) dhe Vushtri (ndërtimi i terrenit për trajnim në fshatin Dobërlukë);
18. Projektet e financuara përmes GPK-së, të cilat u zbatuan siç duhet dhe u futën në shfrytëzim (rasti i Shtimes me trotuarin, hapësirat e gjelbra, ndriçimin publik etj), kanë përmirësuar jetën e grupeve të marginalizuara/të cenueshme;
19. Dëgjimet buxhetore janë shumë formale dhe të organizuara në një masë të madhe për shkak të kërkesave legjislative. Megjithatë, pjesëmarrja e qytetarëve (përfshirë grupet e marginalizuara/ të cenueshme) është vlerësuar të jetë shumë e ulët. Në shumicën e komunave, këto lloje të dëgjimeve nuk nxisin debate dhe disa OJQ lokale i vlerësojnë ato si vende ku marrin pjesë njerëz të lidhur me qeverinë lokale, në mënyrë që të mos i lënë ata të dështojnë;

- 20.** Numri i dëgjimeve buxhetore varion nga dy (2) deri në dhjetë (10) dhe përfshinë gjithashtu edhe lokacione tjera më të vogla, të ndryshme nga qyteti. Sidoqoftë, pjesëmarrja është shumë e ulët, nuk ka dëshmi të pjesëmarrjes së grupeve të marginalizuara dhe nuk është dhënë asnjë shembull ku nevojat/kërkesat e grupeve të tilla kanë qenë të përfshira në agjendën e dëgjimeve buxhetore të organizuara vitin e kaluar;
- 21.** BPGj-ja zbatohet në tetë komunat e vlerësuara në atë masë që kërkohet nga shablloni i Ministrisë së Financave. Sipas dy shembujve të dhëna nga dy komuna, BPGj-ja reflektohet në tre elemente: 1) numri i përgjithshëm i stafit është i ndarë sipas gjinisë (dhe planifikimi për vitin e ardhshëm), 2) niveli i pagave për këtë staf, për shembull sa prej tyre marrin 300-400 euro, edhe kjo është e ndarë sipas gjinisë dhe 3) subvencionet për përfituesit janë të ndara sipas gjinisë, përfshirë planifikimin për vitin e ardhshëm. Sidoqoftë, mbledhja e këtyre të dhënave bëhet manualisht nga Drejtori për Buxhet dhe Finance ose Zyrtari Kryesor Financiar nga të gjitha drejtoritë dhe njësitë nga ku është shpenzuar buxheti në formë të subvencioneve. Kjo gjë do të thotë që nuk ekziston asnjë sistem i paracaktimit të klasifikimit të shpenzimeve të tilla, por të dhënat mblidhen pothuajse manualisht nga sistemi dhe integrohen në shabllonet e ofruara nga Ministria e Financave (shih një shembull në seksionin e BPGj-së);
- 22.** Përveç kërkesave individuale të qytetarëve dhe grupeve të marginalizuara në komunë, pjesëmarrja e qytetarëve në proceset e politikbërjes dhe vendimmarrjes është e ulët, pasi që jo shumë qytetarë marrin pjesë në takime dhe dëgjime buxhetore të organizuara nga komuna. Asnjë formë tjetër e konsultimeve/pjesëmarrjes ndërmjet komunës dhe qytetarëve nuk është vërejtur të ketë ndodhur. Besimi në organizime dhe në efekt të takimeve publike është i ulët, thjesht as komuna dhe as qytetarët nuk besojnë më në evente të tilla.



# Marrja parasysh dhe adresimi i nevojave dhe kërkesave të grupeve të marginalizuara/të cenueshme gjatë planifikimit të projekteve kapitale komunale

Nevojat dhe kërkesat e grupeve të marginalizuara/të cenueshme merren parasysh nga komunat, veçanërisht kur ka kërkesa direkte dhe individuale nga këto grupe. Gjithashtu as kërkesat që bëhen përmes takimeve publike dhe dëgjimeve buxhetore nuk lihen pas dore. Për qëllime ilustrimi, kishte një kërkesë individuale nga një përfaqësues i një zone të largët në Drejtorinë për Shërbime Publike kur u vizitua komuna e Kaçanikut, pasi që takimi u zhvillua në të njëjtën drejtori/zyrë. Kërkesa u regjistrua dhe gjithashtu u morën detajet e kontaktit, dhe iu premtua përfaqësuesit që zyrtarët përkatës nga komuna do të vijnë dhe do ta vizitojnë vendin për ta vlerësuar gjendjen reale. Gjithashtu, siç jepet nga Komuna e Shtimes (dhe kjo vlen në të gjitha komunat e vizituara), pavarësisht se ku paraqiten kërkesat e grupeve të marginalizuara, ato regjistrohen në zyrën e Kryetarit të Komunës dhe drejtorive specifike. Pastaj, krijohen komitete speciale për të shqyrtuar kërkesat e mbledhura dhe për të vendosur në përputhje me rrethanat. Në këtë pikë, nga intervistat me zyrtarë komunalë, grupet e marginalizuara, OJQ-të lokale, mund të thuhet që nevojat dhe kërkesat e grupeve të marginalizuara merren parasysh kryesisht përmes kërkesave individuale. Bazuar në këtë, mund të arrijmë në përfundim që nevojat dhe kërkesat e grupeve të marginalizuara/të cenueshme në tetë komunat e vizituara janë marrë parasysh dhe adresuar, megjithatë adresimi i tyre është sporadik, i atypëratyshëm (ad-hoc), jo i vazhdueshëm dhe jo i programuar.<sup>1</sup> Në këtë drejtim, asnjë nga komunat nuk kanë bërë hartëzim të shqetësimeve të grupeve të marginalizuara/të cenueshme në komunë. Për më tepër, asnjë kategori/ grup i personave të marginalizuar/të cenueshëm, për të cilët duhet të vihen në dispozicion shërbime/projekte/ burime shtesë, nuk u identifikua në mënyrë formale/zyrtare. Megjithatë, kur u bë pyetja se nëse ndonjë nga kategoritë e tilla konsiderohen si prioritet në komunën tuaj, disa komuna kanë përmendur grupe të caktuara ku për ta prioritet janë projektet kapitale dhe burimet.

Në këtë aspekt, komuna e Lipjanit, Kaçanikut, Shtimes, Podujevës dhe Vushtrrisë kanë deklaruar që prioritet u jepet shqetësimeve të personave me aftësi të kufizuara. Për këtë qëllim, komuna e Lipjanit<sup>2</sup> ka ndërtuar 12 platforma përgjatë qytetit të cilat përbëhen nga trotuare, rrugëkalime, semaforë me sistem sinjalizues, të cilat janë adekuate për personat me

<sup>1</sup> Intervista me dy përfaqësues nga dy Shoqata të Grave në dy komuna, Vushtrri dhe Novobërdë.

<sup>2</sup> Takim me Shaban Sylja - Drejtorja për Buxhet dhe Financa, Valzium Mziu - Zyrtar i Projektit, Afrim Mena - Zyra e Handikos dhe Hasan Luma - Zyrtar për Barazi Gjinore, 19 nëntor 2020, Lipjan

nevoja të veçanta, sidomos për ata me nevoja fizike dhe personat e shurdhër që i përdorin rrugëkalimet. Gjithashtu, disa vendparkime përgjatë qytetit janë rezervuar për personat me aftësi të kufizuara, për ata që i përdorin veturat e tyre. Në anën tjetër, sipas Drejtorit të Handikos-it në komunën e Lipjanit këto vendparkime nuk janë mjaftueshëm të mëdha, pasi që nuk ka shumë hapësirë për të hapur derën dhe parkuar veturën, sepse më shumë hapësirë nevojitet për këtë kategori. Gjithashtu, qytetarët që nuk i përkasin kësaj kategorie zakonisht i parkojnë veturat e tyre në këto vendparkime, dhe nuk marrin dënime nga policia. Për më tepër, sipas një përfaqësuesi të një OJQ-je që e takuam në Lipjan, ka rreth 200 të rinj me aftësi të kufizuara, të moshës nga 1 deri 18 vjeç, të cilët janë mbështetur vetëm një herë nga komuna me një projekt të vlerësuar rreth 2000 euro, i cili zgjatë për rreth 4 muaj. Sipas këtij përfaqësuesi, këta të rinj kanë nevojë për shërbime sociale në baza ditore dhe javore, varësisht nga nevojat e tyre, dhe ata nuk janë mbështetur vazhdimisht nga komuna.

Në këtë aspekt, komuna e Kaçanikut<sup>3</sup> ka hequr pengesat në zona të caktuara të qytetit ndërmjet trotuareve, duke i bërë më të lehta për tu kaluar nga personat me aftësi të kufizuara të cilët përdorin karriget me rrota. Tjetër shembull i kësaj natyre nga komuna e Kaçanikut është kur komuna i është referuar një kërkesë të një individi me nevoja të veçanta, i cili së fundmi ka themeluar një OJQ dhe ka kërkuar nga komuna të ketë një zyrë për të, dhe në fakt për OJQ-në. Si rezultat i kësaj, komuna i ka rezervuar atij një zyrë në objektin e Qendrës për Punë Sociale, por personi në fjalë e ka refuzuar këtë ofertë për shkak që zyra është e madhe, jo e përshtatshme dhe tualetet nuk i plotësojnë kriteret për personat me nevoja të veçanta. Sipas komunës, kjo çështje ka mbetur e hapur për momentin dhe do të tentohet të zgjidhet përmes zyrës së Handikos-it.

Gjithashtu edhe komuna e Shtimes<sup>4</sup> i ka dhënë prioritet personave me aftësi të kufizuara. Sipas përfaqësuesve të komunës që i kemi takuar, ekzistojnë disa projekte nga të cilët kanë përfituar personat me aftësi të kufizuara. Për shembull, rregullimi i tre trotuareve përgjatë tre rrugëve kryesore, që nga viti 2014 deri 2019, të zbatuara përmes GPK-së, i kanë ndihmuar të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara, të rinjtë, gratë, të ecin lirshëm në këto pjesë të qytetit. Pastaj, është rregulluar parku pranë Qendrës Rinore i përbërë nga ambiente sportive për t'u shfrytëzuar nga të rinjtë, të moshuarit (pasi që mund të luhet shah dhe ping pong), gratë, dhe personat me nevoja të veçanta. Gjithashtu, janë ndërtuar shtigje për ecje rrejt 10 km të gjatë, midis fshatit Petrovë dhe Vanishtë. Gjithashtu edhe një park tjetër është në ndërtim e sipër (afër pishave) me disa fusha sportive si p.sh. për ping pong, tenis, futboll, volejball, basketboll - dhe ky është një projekt i bashkëfinancuar nga komuna dhe Ministria e Zhvillimit Rajonal (MZHR) - i cili ka filluar në vitin 2020 dhe këtë vit pritet që të përfundojë faza e parë, ndërsa faza e dytë pritet për vitin 2021.

3 Takim me Ramadush Osmanin - Drejtor për Buxhet dhe Financa, Fadil Guri - Zyra për Komunitet dhe Kthim, Vedat Dema - Koordinator i Zyrës për Barazi Gjinore dhe Shkodran Sopa - Zyrtar i Projektit (nuk është më i punësuar në komunë).

4 Takim me Hamez Tershani - Drejtor i Shërbimeve Publike, Fatmir Rexhep - Zyrtar i Projektit, Ibrahim Demiri - Zyra për Komunitet dhe Kthim, Kimete Uka - Zyrtare Kryesore Financiar dhe Reshat Gashi - Zyrtar për Barazi Gjinore..

Komuna e Vushtrisë<sup>5</sup> është shembull tjetër i një komune që u jep prioritet personave me aftësi të kufizuara. Sipas zyrtarëve komunalë që i kemi takuar, dhe në bazë të konfirmimit nga Drejtori i Handikos-it në këtë komunë, zyra e Handikos-it mbështetet çdo vit me nga 12,000 euro për nevojat e tyre sipas plan projektit të propozuar, ndërsa komuna organizon transportin e fëmijëve me nevoja të veçanta - nga shtëpitë e tyre tek qendrat e rehabilitimit - varësisht nga nevojat e tyre.

Një tjetër komunë e cila shërben si shembull sa i përket marrjes parasysh të nevojave dhe kërkesave të personave me aftësi të kufizuara është ajo e Podujevës<sup>6</sup>. Sipas zyrtarëve komunalë që i kemi takuar, dhe në bazë të konfirmimit nga Drejtori i Handikos-it në këtë komunë, komuna çdo vit dhuron bursa për persona me nevoja të veçanta sa herë që ata paraqesin kërkesa të tilla. Gjithashtu komuna çdo vit organizon një ditë pune në administratën e komunës për personat me nevoja të veçanta, varësisht nga ajo se çfarë janë në gjendje të bëjnë ata persona, dhe i paguajnë nga 10 euro secilin për këtë aktivitet.

Në anën tjetër, përfaqësuesi i Handikos-it që e takuam na dha një shembull kur nuk janë marrë parasysh nevojat e një familjeje me nevoja të veçanta. Ai iu referua një rasti kur një familje me anëtarë me nevoja të veçanta kërkoi nga komuna që t'i ndërtojë një shtëpi, por komisioni përkatës komunal vendosi që mos ta realizojë këtë kërkesë sepse ajo familje nuk ishte e kualifikuar për këtë gjë.

## Dizajnimi dhe planifikimi i projekteve kapitale komunale

Zyrtarët komunalë të cilët i takuam deklaruan që gjatë planifikimit dhe dizajnit të projekteve kapitale që do të zbatohen në komunë, do t'i marrin parasysh nevojat/kërkesat e grupeve të marginalizuara/të cenueshme. Megjithatë, kur i kërkuam atyre që tregojnë ndonjë rast ku i kanë marrë parasysh nevojat/kërkesat e këtyre grupeve, p.sh. gjatë procesit të planifikimit të vitit të kaluar, ata nuk ishin në gjendje ta tregojnë ndonjë. Gjithashtu, kur i pyetëm ata lidhur me dëgjimet buxhetore dhe se a kanë qenë temë nevojat/kërkesat e grupeve të marginalizuara gjatë dëgjimeve buxhetore të vitit të kaluar, asnjë komunë nuk deklaroi që i kishte këto nevoja/kërkesa të këtyre grupeve pjesë të agjendës së dëgjimeve buxhetore.

5 Takim me Njomza Ramën - Kabineti i Kryetarit të Komunës, Lutfi Gerguri - Drejtor për Buxhet dhe Financa, Refik Maloku - Drejtor i Urbanizmit, Remzije Zekolli - Zyrtar për Barazi Gjinore dhe Ekrem Miftari - Zyrtar i Projektit.

6 Takim me Kadrie Ajvazi - Drejtorja për Buxhet dhe Financa, Naime Podvorica - Zyrtare për Barazi Gjinore, Naime Ajeti - Zyrtare për Emergjencja dhe Idriz Hoxha - Zyra e Handikos në Podujevë.

Edhe nëse komunat marrin ndonjëherë parasysh nevojat/kërkesat e grupeve të marginalizuara/të cenueshme, nuk është që ato kanë ndonjë formulë apo program se si ta peshojnë propozimin dhe çfarë duhet të bëhet së pari dhe çfarë më pas. Kjo është si pasojë që komunat nuk e dinë gjendjen e grupeve të marginalizuara/të cenueshme brenda komunës. Siç u përmend, kjo varet në masë të madhe, ndonëse jo plotësisht, nga rishikimi rast pas rasti, bazuar në projekt propozimin dhe nuk ka vizion se çfarë duhet të mbështetet, si dhe kur një kërkesë duhet të mbulohet, dhe më e rëndësishmja, nuk është i garantuar aspekti i qëndrueshmërisë në asnjë financim. Kur i shohim vendimet e komunave që shpenzojnë përmes subvencioneve, zyrës së kryetarit të komunës dhe zyrave të tjera (përfshirë përmes Zyrës për Çështje të Komunitetit dhe Zyrës për Barazi Gjinore), e vërejmë se shumë buxhet është shpenzuar për këto kategori, por në një perspektivë afatgjate gjendja e tyre nuk është përmirësuar. Kjo sepse financohen përfaqësuesit e grupeve të marginalizuara, dhe të njëjtit vijin përsëri me të kërkesa të njëjta. Për shembull, zyrat e Handikos-it në shumicën e komunave të vizituara marrin subvencione nga komuna përkatëse për financimin e aktiviteteve me personat me nevoja të veçanta, ose gratë që merren me bujqësi marrin financime përmes shoqatave, ose të rinjtë marrin mbështetje financiare përmes përfaqësuesve të tyre, megjithatë, kërkesat e njëjta bëhen edhe vitin tjetër (siç janë kërkesa për të mbuluar qiranë e zyrave, faturat e energjisë elektrike, materialet e zyrës dhe për projekte të vogla në zhvillim e sipër të cilat organizohen çdo vit). Ky është problem për komunat pasi që, para së gjithash, nuk ka ndonjë hartëzim të shqetësimeve për grupet e marginalizuara/të cenueshme dhe mbështetja financiare ofrohet në baza ad-hoc pa pasur planifikim prapa.

## Grumbullimi i nevojave/kërkesave të grupeve të marginalizuara/të cenueshme nga komuna

Komunat e vizituara, si dhe grupet e marginalizuara të kontaktuar<sup>7</sup> nuk kanë theksuar ndonjë formë të veçantë se si komuna grumbullon nevojat/kërkesat e grupeve të marginalizuara/të cenueshme të cilat jetojnë në komunë. Në rastin e Lipjanit, sipas përfaqësuesit të OJQ-së Polis, kjo OJQ bën shumë më shumë përpjekje për ta informuar komunën për nevojat e grupeve të tilla sesa vetë komuna. Sipas tyre, dëgjimet buxhetore janë shndërruar në vende ku nuk nxitet asnjë debat/diskutim dhe ka më shumë njerëz që janë të lidhur me parti politike vetëm e vetëm që mos t'i lënë ato të dështojnë për shkak të mos pjesëmarrjes së qytetarëve.

Në pyetjes sa i përket formave/mënyrave se si i grumbullon komuna nevojat/kërkesat e grupeve të marginalizuara, tabela në vijim në anën e majtë të saj përshkruan alternativat, kurse në të djathtë janë emrat e komunave të cilat e zbatojnë atë metodë të caktuar.

<sup>7</sup> Intervistë përmes telefonit me një përfaqësues të grupeve të marginalizuara nga Shoqatat e të Verbërve në komunën e Istogut.

**Tabela 1:** Mënyrat se si i grumbullon komuna nevojat/kërkesat e grupeve të marginalizuara/të cenueshme

Takim publik me qytetarët	Istog, Kaçanik, Novobërdë, Shtime dhe Vushtri
Kërkesat individuale të grupeve të marginalizuara/të cenueshme	Istog, Kaçanik, Shtërpçë, Shtime, Vushtri dhe Novobërdë
Dëgjimet buxhetore	Kaçanik, Lipjan, Novobërdë, Shtërpçë, Shtime dhe Vushtri
Takime konsultative që kanë për synim nevojat dhe kërkesat e grupeve të marginalizuara	Vushtri

Siç mund të shihet nga tabela e mësipërme, komunat nuk organizojnë asnjë event ku i grumbullojnë nevojat/kërkesat e grupeve të marginalizuara. Nga komunat e renditura më lartë, vetëm komuna e Vushtrisë (konfirmuar edhe nga OJQ-të lokale dhe grupet e marginalizuara) organizon takime më të vogla dhe në fshatra/lokacione (fshatra si Prelluzhë dhe Gojbulë) ku jetojnë grupet e marginalizuara që të mbledhin nevojat dhe shqetësimet e tyre.

## Përpyjekjet e veçanta të komunave për t'i arritur grupet e marginalizuara/të cenueshme gjatë planifikimit të buxhetit

Sipas kornizës së komunikimit ndërmjet komunës dhe grupeve të marginalizuara/të cenueshme, një pyetje e veçantë u është parashtruar komunave nëse këto të fundit bëjnë ndonjë përpjekje të veçantë për t'i arritur grupet e tilla gjatë planifikimit të buxhetit dhe projekteve kapitale. Nga komunat e vizituara, OJQ-të e takuara, dhe grupet e marginalizuara të intervistuar përmes telefonit, përveç komunës së Vushtrisë dhe Istogut të cilat kanë organizuar diçka në këtë drejtim, asnjë komunë tjetër nuk ka regjistruar asgjë. Sa i përket komunës së Istogut, përpjekje të tilla të veçanta janë bërë edhe me organizata ndërkombëtare si USAID dhe OSBE, aktivitete të cilat janë organizuar në vitin 2019 në fshatin Dobrushë (ku ka komunitet boshnjak) për t'u informuar më mirë për nevojat e tyre dhe projekt propozimet që mund të adresohen me buxhetin e vitit të ardhshëm.

Në rastin e Vushtrisë, sipas zyrtarëve komunalë që i kemi takuar, komuna paraprakisht ka realizuar një anketë online me qytetarë për t'i parë se cilat janë prioritetet e tyre sa i përket projekteve kapitale. Projektet lidhen me furnizim me ujë të pijshëm, sistemin e kanalizimit, trotualet dhe ndriçimin publik kanë dalë si prioritete për komunën nga qytetarët.

# Shpenzimet buxhetore për secilin grup të marginalizuar

Në mënyrë që të analizohet se sa e shpenzojnë buxhetin komunat në baza vjetore për grupet e marginalizuara/të cenueshme, është shtruar një pyetje e veçantë lidhur me atë se nëse komunat i klasifikojnë shpenzimet buxhetore për grupet e marginalizuara. Nga të gjitha përgjigjet e dhëna, është nënkuptuar që asnjë komunë nuk ka klasifikim të buxhetit për t'u shpenzuar për secilin grup të marginalizuar. Rrjedhimisht, projekt propozimet nga këto grupe financohen përmes burimeve të ndryshme buxhetore, siç janë subvencionet, zyra e Kryetarit të Komunës dhe drejtoritë individuale. Sa i përket mënyrës se si rregullohet kjo gjë, komuna e Shtimes ka deklaruar se ajo themelon komitete të veçanta për të vendosur se çfarë projekte të mbështesin dhe përmes çfarë buxheti t'i mbështesin ato, si dhe komuna e Podujevës, ku katër drejtoritë e angazhuara për mbështetjen financiare të projektit për grupet e marginalizuara (bujqësi, shëndetësi, arsim dhe kulturë) krijojnë komitete të veçanta për të vendosur në përputhje me rrethanat. Kjo nënkupton se nuk ka klasifikim të buxhetit ose kategori të veçanta ku projekti i financiar (buxheti) alokohet për kategori specifike. Për më tepër, në rastin e komunës së Istogut, zyrtarët të cilët i kemi takuar kanë deklaruar se ata mbulojnë disa shpenzime, përfshirë qiranë e zyrës dhe faturat e energjisë elektrike, nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve. Gjithashtu, komuna e Istogut mbulon shpenzimet komunale mujore të Shoqatës së të Verbërve, Handikos-it dhe Qendrës Rinore në Gurakoc, përmes kategorisë së shpenzimeve komunale. Në këtë mënyrë, mund të thuhet se projekt propozimet nga grupet e marginalizuara merren parasysh dhe financohen, megjithatë, sipas shembujve të dhënë nuk mund të thuhet se ka ndonjë qasje unike dhe të integruar në financimin e projekt propozimeve.

Nga një skanim i thjeshtë i Ligjit mbi Buxhetin për vitin 2020, është qartësuar se shpenzimet e tilla nuk klasifikohen askund në buxhet. Në këtë aspekt, komunat e synuara në këtë raport janë skanuar nëse kanë buxhet të veçantë për komunitet dhe kthim (si ilustrim), dhe cili është buxheti i tyre për investime kapitale dhe subvencione dhe transferime. Rezultatet janë si në vijim:

**Tabela 2:** Investimet kapitale dhe subvencionet dhe transferet buxhetore të Zyrave për Çështje të Komunitetit në 8 komuna

Komuna	Zyra për Komunitete dhe Kthim	Buxheti për investime kapitale (EUR)	Buxheti për subvencione dhe transfere (EUR)
Istog	Po	150,000	5,000
Kaçanik	Po	0	0
Lipjan	Po	0	2,000
Novobërdë	Po	0	0
Podujevë	Po	0	0
Shtërpçë	Po	0	0
Shtime	Po	0	6,500
Vushtrri	Po	0	0

Burimi: Ligji Nr. 07/L-001 mbi Buxhetin për vitin 2020, Ministria e Financave

# Projektet kapitale të financuara përmes GPK-së, pjesë e prioriteteve ose listës rezervë

Nga komunat e vizituara dhe projektet e financuara përmes GPK-së, një pyetje e veçantë u është parashtruar zyrtarëve komunal nëse projektet e financuara përmes GPK-së janë planifikuar si projekte me prioritet për tu financuar, ose kanë qenë pjesë e listës rezervë, dhe kur u ofrua GPK-ja, komuna vetëm doli me një projekt kapital për tu mbështetur përmes GPK-së. Tabela në vijim bën një ndarje të projekteve sipas listës së prioriteteve dhe listës rezervë të komunës - bazuar në përgjigjet e komunës (Drejtoritë e Buxhetit dhe Financave) mbi këtë pyetje.

**Tabela 3: Projektet e vizituara dhe financuara përmes GPK-së, pjesë e listës së prioriteteve dhe listës rezervë në projektet kapitale komunale**

Nr.	Komuna	Nr. i projekteve	Projekti/et	Lista e prioriteteve	Lista rezervë
1	Istog	1	Rregullimi i hapësirës dhe infrastrukturës përreth sallës së sporteve		√
2	Kaçanik	2	Rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve të qytetit	√	
			Ndërtimi i trotuareve në lagjen Imisht	√	
3	Lipjan	1	Vendosja e pajisjeve sinjalizuese në qytetin e Lipjanit	√	
4	Novo-berde	1	Rregullimi i stadiumit të futbollit në fshatin Prekovic		√
5	Podujevë	2	Ndërtimi i ambulancës në fshatin Majac	√	
			Ndërtimi i shtëpive për rastet me asistencë sociale në "Lagjen e Dëshmorëve" në Balloc	√	
6	Shtime	1	Rregullimi i trotuareve, ndriçimit publik dhe hapësirave të gjelbra në rrugët "Komandant Kumanova" (pjesa e mbetur), "Tahir Sinani", "Anton Çeta" dhe të hapësirës për parking tek shkolla "Emin Duraku"	√	

7	Shtërpcë	2	Rindërtimi i ndriçimit publik, vendosja e teknologjisë LED në fshatin Firajë		√
			Rregullimi i kanalit dhe trotuarit në Brezovicë		√
8	Vushtrri	2	Ndërtimi i terrenit për stërvitje në stadiumin e futbollit në Dobërllukë		√
			Rindërtimi i hapësirave në sheshe në Stanoc i Poshtëm, Novolan, Maxhunaj, Bukosh, Nedakoc, Druar, Banjaskë, Studime e Poshtme, Stanoc i Epërm dhe në qytetin e Vushtrrisë (12 projekte)		√
		12		6	6

# Përfitimet që grupet e marginalizuara gëzojnë nga projektet kapitale komunale të zbatuara në komuna

## Përmbledhje

Lista e komunave dhe projektet e financuara përmes GPK-së janë përcaktuar paraprakisht dhe gjithashtu janë kryer vizitat në vendet ku u zbatuan projektet (projektet aktuale). Çdo vizitë u realizua pas takimit të parë me zyrtarët komunalë (veçanërisht me zyrtarin e projektit specifik) dhe u vëzhgua dhe diskutua se nëse kanë përfituar dhe si kanë përfituar grupet e marginalizuara nga projekti në fjalë, dhe nëse ka përmirësuar jetën e njërit grup të marginalizuar ose tjetrit. Në komunat ku janë zgjedhur më shumë se një projekt, për shkak të distancës dhe marrëveshjes së mëparshme me DEMOS-in, vetëm njëra nga to u vizitua në vend, megjithatë ka vazhduar të bëhen pyetje lidhur me tjetrin projekt. Seksioni në vijim ofron një përshkrim të shkurtër të projektit, duke përfshirë një fotografi të bërë në vend në ditën e vizitës, dhe një gjykim në tryezë mbi përfitimet e grupeve të marginalizuara nga projekti. Për të qenë më të qartë, tabela përfshin përfitues të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë, që do të thotë se përfitues të drejtpërdrejtë janë ato kategori ose grupe që kanë përfituar drejtpërdrejt nga projekti, dhe përfituesit e tjerë të tërthortë nuk janë përfitues të vërtetë. Sidoqoftë, duke marrë parasysh faktin që projekti mund të përdoret ende në mënyrë të tërthortë, tabela është përpjekur ta shfaqë edhe këtë.

## Istogu<sup>8</sup>

Projekti i cili u zbatua përmes GPK-së në komunën e Istogut është: "Rregullimi i hapësirës dhe infrastrukturës përreth sallës së sporteve". Vetë qendra sportive financohet përmes Ministrisë së Kulturës, ndërsa hapësira përreth saj përfshirë kanalin e ujit, hapësira e gjelbër (disa bimë), ulëset, vendparkimet përfshirë vendet e rezervuara për personat me nevoja të veçante, duket se janë financuar në pjesën përreth. Meqenëse në qendrën sportive përf-

<sup>8</sup> Takim me Hysni Maxharraj - Drejtor i Buxhetit dhe Financave, Jashar Blakaj - Drejtor i Urbanizmit (gjithashtu zyrtar i projektit), Abedin Neziraj - Zyra për Komunitete dhe Kthim, Arlinda Kurtaj - Zyrtare për Barazi Gjinore dhe Enver Rugova - Drejtor i Shërbimeve Publike..

shihen disa disiplina që i targetojnë të rinjtë (siç janë basketbolli, futbollit, volejbollit), të rinjtë mendohen të jenë përfituesit e drejtpërdrejtë të projektit të zbatuar përmes GPK-së në këtë komunë, pasi që është përreth qendrës sportive, vend që frekuentohet kryesisht nga të rinjtë.

Sidoqoftë, kur vizituam këtë projekt më datë 5 nëntor, as qendra sportive dhe as rregullimi i zonës përreth nuk kishin përfunduar. Meqenëse projekti përfshinë zonën përreth qendrës sportive, fotografia në vijim mbulon vetëm një pjesë të projektit përkatës. Aty shihet që projekti është gati në përfundim dhe sipas komunës, do të përfundojë brenda dhjetë ditësh. Nga grupet e marginalizuara si përfituese të tërthortë të projektit, mund të përfshihen gra, persona me nevoja të veçanta për shkak të vendparkimeve të rezervuara për ta, nëse ata shkojnë për të parë ndonjë ndeshje sportive, dhe gjithashtu pensionistë/të moshuar që mund ta shfrytëzojnë zonën përreth për të ecur dhe për tu ulur. Megjithëse projekti nuk është i lidhur drejtpërdrejt me RAE, fakti që të rinjtë janë përfituesi kryesor i projektit do të thotë që anëtarët e rinj të komunitetit RAE janë gjithashtu përfitues të projektit.



**Fotografi e realizuar më 5 nëntor**

Tabela në vijim tenton që të klasifikojë më mirë përfituesit e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë nga projekti ‘Rregullimi i hapësirës dhe infrastrukturës përreth qendrës sportive’.

**Tabela 4:** Grupet e marginalizuara përfitues të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë të projektit të zbatuar përmes GKP-së në komunën e Istogut.

Grupi i marginalizuar/i cenueshëm	Përfitues i drejtpërdrejtë	Përfitues i tërthortë
Personat me aftësi të kufizuara	X	√
RAE	X	√
Të rinjtë (femra/meshkuj të rinj)	√	√
Gra	X	√
Pensionistët/të moshuarit	X	√
Banorët e vendeve të largëta rurale	X	X
Komunitete të tjera jo shumicë	X	√

Sa i përket përmirësimit të jetës së grupeve të marginalizuara/të cenueshme nga projekti i zbatuar, përfaqësuesi i OJQ-së lokale "ABA" në Istog siguron që "salla e sporteve ka përmirësuar qasjen e të rinjve në aktivitetet sportive dhe rregullimi i zonës përreth ka bërë të gjithë zonën më tërheqëse".<sup>9</sup>

## Kaçanik

Janë dy projekte të cilat janë zbatuar përmes GPK-së në komunën e Kaçanikut në vitin 2018 dhe 2019: 1) Rregullimi i trotuareve në lagjen Imisht në vitin 2018 dhe 2) Rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve të qytetit. Projekti i parë është vizituar ndërsa projekti i dytë është vëzhguar në qendër të qytetit dhe fotoja më poshtë shfaqë një pjesë të trotuarit të zbatuar në lagjen Imisht. Kjo lagje është në fshatin Dubravë dhe vetë fshati është rreth 7-8 km larg nga qendra e Kaçanikut. Sipas zyrtarit përkatës të projektit dhe takimit me zyrtarët komunalë, ky projekt është zgjedhur për shkak të rëndësisë që kishte për fëmijët që të vijnë nëpër këtë rrugë në shkolla (zona afër ka dy shkolla, një shkollë fillore dhe një të mesme). Sipas zyrtarit të projektit, trotuari është rreth 3 km i gjatë dhe tani shërben si zonë e sigurt për të ecur fëmijët, por përdoret gjithashtu nga banorët duke përfshirë të moshuarit/pensionistët, gratë dhe banorët e vendeve të largëta rurale që vijnë nga kjo zonë.

<sup>9</sup> Përgjigja e dhënë më 3 nëntor 2020 nga OJQ-ja lokale "ABA".



**Fotografia e realizuar më 13 nëntor**

Trotuari është ndërtuar pasi që nuk ekzistonte më parë dhe eliminoi rrezikun për këmbësorët, të cilët deri më tani kanë përdorur rrugën për të ecur nëpër lagje. Në lidhje me klasifikimin e grupeve të përfituesve të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë të projektit, shihni në tabelën vijuese.

**Tabela 5: Përfituesit e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë të projektit, të financuar përmes GPK-së në komunën e Kaçanikut (fshati Dubravë, lagjja Imisht)**

Grupi i marginalizuar/i cenueshëm	Përfitues i drejtpërdrejtë	Përfitues i tërthortë
Personat me aftësi të kufizuara	X	√
RAE10	X	X
Të rinjtë (femra/meshkuj të rinj)	√	√
Gra	X	√
Pensionistët/të moshuarit	X	√
Banorët e vendeve të largëta rurale	X	X
Komunitete të tjera jo shumicë 11	X	X

Sa i përket përmirësimit të jetës së komuniteteve, projekti ka përmirësuar jetën e të rinjve të cilët shfrytëzojnë trotuarin për të shkuar në shkollë, por gjithashtu gratë si këmbësore shfrytëzojnë trotuarin me fëmijë për të ecur nëpër lagje. Sipas zyrtarit të projektit i cili ka udhëhequr këtë projekt nga ana e komunës në atë kohë, “përpara se të rregullohej trotuari, ka qenë e rrezikshme për të rinjtë që ecnin përgjatë rrugës për të shkuar në shkollë për shkak të makinave”. Sipas tij, gjithashtu janë bërë përpjekje që të ndërtohet një trotuar më i madh, mirëpo banorët që banojnë aty pranë e refuzuan këtë për shkak të çështjeve pronësore.<sup>12</sup>

10 Nuk janë të pranishëm në këtë zonë.

11 Nuk janë të pranishëm në këtë zonë.

12 Vizitë në vend/terren me Shkondran Sopa, zyrtar i projektit i cili nuk punon më për komunën.

# Lipjan

Projekti i cili është zbatuar përmes GPK-së në komunën e Lipjanit është: “Vendosja e pajisjeve sinjalizuese në qytetin e Lipjanit”. Sipas komunës, ekzistojnë 12 ose 15 platforma të tilla për vendkalime të cilat janë zbatuar në të gjithë qytetin - është bërë dhe ndriçimi mbi vendkalim. Vendkalimi është ndërtuar në mënyrë të tillë që kalohet lehtësisht nga njerëzit me nevoja të veçanta (që përdorin karriget me rrota) si dhe semaforët janë me sistem sinjalizues - për personat e verbër.

Për sa i përket grupeve të përfituesve të drejtpërdrejtë nga projekti, personat me nevoja të veçanta kanë përfituar nga ky projekt, megjithatë, në mënyrë të tërthortë përfitues janë të gjithë qytetarët që ecin, duke përfshirë gratë, të moshuarit, etj. Fotografia e mëposhtme tregon një nga platformat e tilla të rregulluara në qendër të qytetit.



**Fotografia është bërë më 19 nëntor**

Tabela më poshtë përpiqet të klasifikojë grupet e përfituesve të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë nga projekti i lartpërmendur.

**Tabela 6:** Grupet e përfituesve të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë nga projekti i financuar përmes GPK-së në komunën e Lipjanit

Grupi i marginalizuar/i cenueshëm	Përfitues i drejtpërdrejtë	Përfitues i tërthortë
Personat me aftësi të kufizuara	√	√
RAE	X	√
Të rinjtë (femra/meshkuj të rinj)	X	√
Gra	√	√
Pensionistët/të moshuarit	√	√
Banorët e vendeve të largëta rurale	X	X
Komunitete të tjera jo shumicë	X	√

Projekti i financuar ka përmirësuar jetën e grupeve të marginalizuara, veçanërisht të personave me aftësi të kufizuara, të të moshuarve/pensionistëve dhe grave. Sipas zyrtarit të projektit, “komuna e Lipjanit shërben si një shembull i mirë për marrjen parasysh dhe adresimin e nevojave të personave me aftësi të kufizuara”.<sup>13</sup> Sa i përket ndikimit të projektit të financuar përmes GPK-së në këtë kategori/grup, përfaqësuesi i OJQ Polis konfirmon se ndërtimi i 12 platformave ka përmirësuar jetën kryesisht të personave me aftësi të kufizuara, por edhe të grupeve të tjera të marginalizuara/të cenueshme.<sup>14</sup>

## Novobërdë<sup>15</sup>

Projekti i cili është zbatuar përmes GPK-së në komunën e Novobërdës është “Rregullimi i stadiumit të futbollit në fshatin Prekoc”. Në anë tjetër, sipas zyrtarit të projektit, projekti ka përfunduar në janar-shkurt të vitit 2020, mirëpo nuk është shfrytëzuar deri më tani për shkak të situatës pandemike. Nga kjo vizitë në vend, vërehet se nuk është shfrytëzuar, madje as nuk ka përfunduar si projekt. Anët përreth fushës së futbollit nuk janë përfunduar, nuk ka drita (rrjeta koshi dhe shtylla goli) - dhe sipas zyrtarit të projektit, këto do të mbulohen nga komuna.

Rinia është përfituesi kryesor i këtij projekti, të rinjtë që jetojnë në fshatin Prekoc - që është i banuar nga komuniteti serb. Ju lutemi shihni foton e mëposhtme ku gjendet stadiumi i futbollit në fshatin Prekoc.

<sup>13</sup> Takimi me Valzim Mziu, Zyrtari i projektit, 19 nëntor 2020.

<sup>14</sup> Takimi me Muhamet Qeriqi, OJQ Polis, 19 nëntor 2020.

<sup>15</sup> Takimi me Slobodan Bogdanovic – Zyrtari i projektit dhe Sami Villasaiu, OJQ Kalaja, 6 nëntor Novobërdë.



**Fotografia e realizuar më 6 nëntor në fshatin Prekoc (Novobërdë)**

Për klasifikimin të grupeve të përfituesve të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë të projektit, tabela e mëposhtme përpiqet të bëjë një ndarje midis përfituesve të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë të projektit.

**Tabela 9: Përfituesit e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë të projektit, të financuar përmes GPK-së në komunën e Novobërdës (Prekoc, Novobërdë).**

Grupi i marginalizuar/i cenueshëm	Përfitues i drejtpërdrejtë	Përfitues i tërthortë
Personat me aftësi të kufizuara	X	X
RAE	X	X
Të rinjtë (femra/meshkuj të rinj)	√	√
Gra	X	X
Pensionistët/të moshuarit	X	X
Banorët e vendeve të largëta rurale	√	√
Komunitete të tjera jo-shumicë <sup>16</sup>	X	X

Sipas OJQ-së lokale GLV Kalaja, “ndërtimi i stadiumit të futbollit në fshatin Prekoc ka qenë i nevojshëm”<sup>17</sup>, megjithatë, meqenëse projekti nuk ka përfunduar akoma dhe të rinjtë nuk kanë qenë në gjendje ta shfrytëzojnë atë ende, me anë të intervistave është e pamundur të dihet se si ky projekt ka përmirësuar jetën e grupeve të marginalizuara/të cenueshme që jetojnë në këtë zonë.

<sup>16</sup> Në fshat nuk jeton asnjë komunitet tjetër.

<sup>17</sup> Takimi me Sami Vllasaliu, OJQ-ja lokale GLV Kalaja, Novobërdë, 6 nëntor 2020.

## Podujevë

Në komunën e Podujevës janë zgjedhur dy projekte të financuara përmes GPK-së. Projekti i parë është: “Ndërtimi i ambulants në fshatin Majac” dhe projekti i dytë është “Ndërtimi i shtëpive për rastet me asistencë sociale në fshatin Ballofc”. Projekti i dytë është vizituar në terren dhe fotografia e mëposhtme lidhet me atë projekt. Në lidhje me projektin e parë, sipas zyrtarëve komunalë të takuar, ndërtimi i ambulants në fshatin Majac (në rrugën Prishtinë-Podujevë) ka eliminuar nevojën e banorëve të zonave të largëta rurale për të ardhur në Podujevë që të përfitojnë nga shërbimet e ofruara nëpër qendra mjekësore. Në lidhje me projektin e dytë, nga ky projekt “Ndërtimi i shtëpive për rastet me asistencë sociale në fshatin Ballofc”, kanë përfituar familjet me asistencë sociale. Para se të ndërtohen këto shtëpi, këto familje kanë qëndruar në kontejnerë. Veteranët dhe invalidët e luftës janë grupet kryesore përfituese nga ky projekt. Lagjja e ndërtuar ka rreth 100 shtëpi, përfshirë këtu ambulants në hyrje të lagjes. Fotografia e mëposhtme është bërë afër lagjes dhe kap një segment të caktuar të të gjithë vendit. Në kohën e vizitës nuk kishte përfunduar plotësisht ndërtimi, megjithatë, sipas zyrtarëve komunalë, së shpejti do të përfundohet dhe do të përurohet.



*Fotografia e realizuar më 25 nëntor përpara shtëpive për rastet me asistencë sociale në fshatin Ballofc, komuna e Podujevës*

Tabela e mëposhtme përpiqet të klasifikojë më mirë përfituesit e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë nga projekti “Ndërtimi i shtëpive për rastet me asistencë sociale në fshatin Ballofc”. Projekti nuk i dedikohet vetëm ndonjë prej grupeve të marginalizuara/të cenueshme siç përcaktohet në këtë pikë. Megjithatë, përfitues të tërthortë mund të jenë të rinjtë, gratë, pensionistët/të moshuarit, personat me nevoja të veçanta që mund të jenë anëtarë të familjeve me asistencë sociale.

**Tabela 10:** Grupet e përfituesve të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë nga projekti i zbatuar në Ballofc, në komunën e Podujevës

Grupi i marginalizuar/i cenueshëm	Përfitues i drejtpërdrejtë	Përfitues i tërthortë
Personat me aftësi të kufizuara	X	√
RAE	X	X
Të rinjtë (femra/meshkuj të rinj)	X	√
Gra	X	√
Pensionistët/të moshuarit	X	√
Banorët e vendeve të largëta rurale	X	X
Komunitete të tjera jo shumicë	X	X

Sipas një zyrtari komunal së bashku me të cilin e kemi vizituar vendin, ndërtimi i shtëpive për familjet me asistencë sociale është një nga projektet më të rëndësishme kapitale të realizuara në komunën e Podujevës në dy vitet e fundit. Bazuar në vizitën dhe shpjegimet e ofruara nga zyrtarët komunalë, ky projekt duket se ka përmirësuar jetën e familjeve të veteranëve dhe invalidëve të luftës të cilët për disa vite kanë jetuar në kontejnerë.

## Shtërpcë<sup>18</sup>

Projekti i cili është financuar përmes GPK-së në komunën e Shtërpcës është “Rregullimi i ndriçimit publik, vendosja e teknologjisë LED në fshatin Firajë”. Fshati Firajë është rreth 7-8 km larg Shtërpcës dhe është i banuar me shqiptarë. Fshati ka dy shkolla, ku në rrugët përreth është vendosur ndriçimi publik i teknologjisë LED. Sa i përket grupeve të marginalizuara/të cenueshme si përfituese të projektit, mund të thuhet se të rinjtë përfitojnë (pasi ka dy shkolla afër), megjithatë, nuk ka trotuar në këtë zonë kështu që as gratë, njerëzit me nevoja të veçanta, as të moshuarit nuk mund të përfitojnë.

Në këtë fshat nuk ka komunitet RAE e as ndonjë komunitet tjetër. Në anën tjetër, gjatë vizitës së projektit dhe bisedës me banorët, sipas tyre, jo të gjitha dritat janë funksionale për momentin.<sup>19</sup> Kjo nuk mund të vërtetohej pasi që projekti u vizitua gjatë ditës; infrastruktura është aty, por nuk mund të vërtetohej nëse funksionon. Për më tepër, komuna hezitoi të angazhonte dikë për të ndezur dritën për qëllime vëzhgimi. Fotografia e mëposhtme është bërë në fshatin Firajë gjatë vizitës së projektit.

18 Takimi me Jeton Rrahmani – Drejtorja për Buxhet dhe Financa, Raif Bajrami – Drejtorja e Urbanizmit (gjithashtu zyrtar i projektit), Ahmeti Aliu – Zyra për komunitete dhe kthim, 26 nëntor Shtërpcë.

19 Biseda me banorët gjatë vizitës së vendit/terrenit ku është zbatuar projekti në fshatin Firajë, 26 nëntor 2020.



**Fotografia e realizuar më 26 nëntor në një lagje ku është vendosur teknologjia LED e ndriçimit publik, fshati Firajë, Shtërpçë**

Në tabelën e mëposhtme është bërë një përpjekje të klasifikohen më mirë përfituesit e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë të projektit “Rregullimi i ndriçimit publik, vendosja e teknologjisë LED në fshatin Firajë”

**Tabela 11: Grupet e përfituesve të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë të projektit të financuar përmes GPK-së në fshatin Firajë, Shtërpçë**

Grupi i marginalizuar/i cenueshëm	Përfitues i drejtpërdrejtë	Përfitues i tërthortë
Personat me aftësi të kufizuara	X	√
RAE	X	X20
Të rinjtë (femra/meshkuj të rinj)	√	√
Gra	X	√
Pensionistët/të moshuarit	X	√
Banorët e vendeve të largëta rurale	√	√
Komunitete të tjera jo shumicë	X	X21

20 Nuk janë të pranishëm

21 Nuk janë të pranishëm

## Shtime

Projekti i cili është financuar përmes GPK-së në komunën e Shtimes është: “Rregullimi i trotuareve, ndriçimit publik dhe hapësirave të gjelbra në dy rrugët kryesore të Shtimes». Meqenëse këto dy rrugë janë larg njëra tjetrës, e vizitua rrugën Tahir Sinani së bashku me zyrtarin e projektit dhe e fotografua vendin. Në varësi të vëzhgimit, të rinjtë, gratë, pensionistët/të moshuarit janë grupet kryesore përfituese nga projekti. Fotografia e mëposhtme tregon një pjesë të projektit, i cili është zbatuar përgjatë rrugës Tahir Sinani, në afërsi të së cilës është një shkollë publike. Ky trotuar përfshin ndriçimin dhe gjelbërimin publik (mbjelljen e pemëve përgjatë trotuarit) dhe është i gjatë 850 metra ndërsa trotuari me elementët e përmendur në rrugën Komandant Kumanova është i gjatë 750 metra. Trotuaret janë ndërtuar në të dy anët e rrugëve.



**Fotografia e realizuar më 19 nëntor, rruga Tahir Sinani, Shtime**

Siç mund të shihet nga fotografia, përfitues të këtij projekti janë të gjithë qytetarët që shfrytëzojnë këtë rrugë, përkatësisht: të rinjtë, gratë (me fëmijë), të moshuarit, njerëzit me nevoja të veçanta, ku qasja në trotuar është e përshtatshme për ta. Sidoqoftë, për një klasifikim më të qartë të grupeve përfituese të drejtpërdrejta dhe të tërthorta nga projekti, shihni tabelën më poshtë.

**Tabela 12: Grupet e përfituesve të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë të projektit të financuar përmes GPK-së në dy rrugët kryesore të Shtimes**

Grupi i marginalizuar/i cenueshëm	Përfitues i drejtpërdrejtë	Përfitues i tërthortë
Personat me aftësi të kufizuara	X	√
RAE	X	√
Të rinjtë (femra/meshkuj të rinj)	√	√
Gra	√	√
Pensionistët/të moshuarit	√	√
Banorët e vendeve të largëta rurale	X	√
Komunitete të tjera jo shumicë <sup>22</sup>	X	√

Ky projekt ka përmirësuar jetën e grupeve të marginalizuara përmes përdorimit të trotuarit për ecje, ku përgjatë trotuarit ka edhe ndriçim publik dhe gjelbërim. Sipas përfaqësuesit të OJQ-së lokale Qendra Rinore (Youth Center), projekti i ka sjellë përfitime qytetarëve pasi që dy rrugë kryesore, të cilat janë të frekuentuara shumë nga qytetarët janë rregulluar me trotuare, ndriçim publik dhe gjelbërim.<sup>23</sup>

## Vushtrri

Projekti i cili është financuar përmes GPK-së në komunën e Vushtrrisë është: “Ndërtimi i terrenit për stërvitje në stadiumin e futbollit në Dobërllukë”. Sipas komunës dhe vizitës së kryer në terren, stadiumi i futbollit nuk ka përfunduar ende. Pas përfundimit, stadiumi i futbollit do të menaxhohet nga Drejtoria për Kulturë dhe pritet që Drejtoria të ketë burime njerëzore për të menaxhuar stadiumin e futbollit. Zona gjendet rreth tre kilometra larg nga qyteti i Vushtrrisë dhe nuk ka infrastrukturë. Mungesa e infrastrukturës e bën projektin jo tërheqës për tu shfrytëzuar, pasi rruga për në stadiumin e futbollit dhe infrastruktura anësore nuk është e asfaltuar. Kur e vizitua stadiumin e futbollit, fëmijët po luanin futboll në stadium edhe pse kompania nuk e kishte përfunduar ende dhe komuna nuk e menaxhon ende atë. Për të parë se si është zona përreth, ju lutemi hidhni një vështrim në fotografinë e mëposhtme të bërë përpara stadiumit të futbollit.

<sup>22</sup> Përveç komunitetit RAE në komunën e Shtimes nuk ka komunitete jo-shumicë.

<sup>23</sup> Takimi me Resul Gashi, 19 nëntor 2020, Shtime.



**Fotografia e realizuar më 16 nëntor në fshatin Dobërllukë, Vushtrri**

Siç u tha më lart, grupi i drejtpërdrejtë i përfituesve të projektit është rinia, megjithatë, do të varet shumë nga menaxhimi i komunës se si do të mirëmbahet, organizohet, si dhe nga burimet njerëzore dhe financiare që do të alokohen për të. Gjithashtu, komuna do të duhet të investojë në infrastrukturë siç është vendi i parkimit, asfaltimi i rrugës e kështu me radhë, për ta bërë projektin funksional dhe tërheqës në mënyrë që të shfrytëzohet nga ekipet e futbollit.

**Tabela 13: Grupet e përfituesve të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë të projektit të financuar përmes GPK-së në fshatin Dobërllukë, Vushtrri**

Grupi i marginalizuar/i cenueshëm	Përfitues i drejtpërdrejtë	Përfitues i tërthortë
Personat me aftësi të kufizuara	X	X
RAE	X	√
Të rinjtë (femra/meshkuj të rinj)	√	√
Gra	X	X
Pensionistët/të moshuarit	X	X
Banorët e vendeve të largëta rurale	X	X
Komunitete të tjera jo shumicë	X	√

Për sa i përket përmirësimit të jetës së grupeve të marginalizuara, nëse përfundohet, menaxhohet mirë, infrastruktura përreth kompletohet, mirëmbahet, ka potencial të jetë një stadium futbollit që do të përdoret kryesisht nga të rinjtë. Sipas një zyrtari komunal<sup>24</sup> "të kesh një stadium të tillë futbollit ka qenë kërkesë e të rinjve për shumë kohë tani dhe kur komuna përfitoi nga GPK-ja për financimin e një projekti kapital, ishte e lehtë për komunën të zgjidhte projektin që do të financohej sipas GPK-së".

<sup>24</sup> Takimi me Njomeza Rama, Kabineti i Kryetarit të Komunës, 16 nëntor 2020, Vushtrri.

## Kush është lënë pas?

Sipas zyrtarëve komunalë që kemi takuar në të gjitha komunat, kur i kemi pyetur për të dhënë arsye se pse në disa raste nuk merren parasysh nevojat dhe kërkesat ose grupet e marginalizuara/të cenueshme, katër nga tetë komunat kanë përmendur mungesën e përfaqësimit dhe pjesëmarrjes. Ky mund të merrej si faktori kryesor pse dikush ka mbetur pas. Një pyetje specifike në pyetësor është futur për këtë qëllim, në përpjekje për t'i përmendur arsyet kundrejt parimit “mos lini askënd pas”. Në mesin e faktorëve të përmendur, tabela në anën e majtë përshkruan arsyet/faktorët për këtë gjë kurse në anën e djathtë përshkruan komunat që i përkasin arsyes/faktorit përkatës.

**Tabela 14:** *Arsyet për mos marrjen parasysh të nevojave/kërkesave të grupeve të marginalizuara/të cenueshme*

Diskriminimi	Asnjë
Distanca (arsye gjeografike)	Istog, Kaçanik
Qeverisja komunale	Istog, Lipjan
Statusi socio-ekonomik	Asnjë
Mungesa e përfaqësimit dhe pjesëmarrjes	Istog, Lipjan, Podujevë, Shtërpçë

# Zbatimi i dëgjimeve buxhetore nga komunat dhe pjesëmarrja nga qytetarët

Dëgjimet buxhetore organizohen nga komunat, nga së paku dy, siç kërkohet sipas legjislacionit deri në 10 si në rastin e Lipjanit - të organizuara në qytet dhe në lokacionet më të vogla përreth. Sidoqoftë, bazuar në diskutimet që kemi pasur me komunat rreth të gjithë procesit të dëgjimeve buxhetore - nga organizimi i hershëm - deri në mbajtjen e tyre, duket se dëgjimet buxhetore janë më së shumti janë organizuar për hir të organizimit të tyre dhe për shkak të kërkesave ligjore në këtë drejtim. Sidoqoftë, duket se vetë komunat nuk kanë besim në mënyrën/formën të cilën janë organizuar, numrin e pjesëmarrësve, debatin e nxitur dhe ndikimin e tyre në propozimet e projekteve kapitale dhe vetë projektbuxhetin. Të gjitha komunat me të cilat jemi takuar kanë ngritur shqetësime në lidhje me pjesëmarrjen e ulët të qytetarëve dhe mungesën e debatit në to. Në anën tjetër, bazuar në diskutimet përmes takimeve me OJQ-të prezentë/aktive në komuna, është ngritur përshtypja e njëjtë e mungesës së interesimit, të pjesëmarrjes dhe të debatit. Madje, siç është rasti i Podujevës, një përfaqësues i OJQ-ve thotë se komuna këtë vit nuk ka organizuar asnjë dëgjim buxhetor. Të njëjtën çështje e përmendi një përfaqësues i një OJQ-je tjetër në Lipjan - ku dëgjimet buxhetore organizohen me njerëz të afërt me partitë politike dhe jo me qytetarë të thjeshtë - vetëm për të thënë se komuna ka organizuar dëgjimet buxhetore të kërkuara me ligj. Në këtë aspekt, komunat duket se kanë treguar më shumë gatishmëri për të përmbushur kriteret ligjore për këtë, sesa që dukej se ishin të interesuara të bëjnë diçka në këtë drejtim.

Siç mund të shihet nga tabela më poshtë, numri i dëgjimeve buxhetore të organizuara në vit varion nga 2 (Kaçanik) në 10 (Lipjan). Sidoqoftë, kur u bë pyetja se nëse dëgjime të tilla nxisin debate midis qytetarëve dhe komunave, vetëm tre komuna kanë deklaruar se ato nxisin debate. Kur u bë pyetja për numrin e pjesëmarrësve, përfshirë grupet e marginalizuara, referenca e zakonshme ishte më pak se 20 pjesëmarrës. Sa i përket agjendës, komunat kanë deklaruar që së pari e paraqesin projekt-buxhetin (qoftë nga Kryetari i Komunës ose Zyrtares Kryesor Financiar si në rastin e Shtimes) dhe më pas Drejtori i Buxhetit dhe Financave detajon më tej buxhetin, përkatësisht kategorinë e investimeve kapitale. Sa i përket pjesëmarrjes së grupeve të marginalizuara në dëgjimet buxhetore, shumica e komunave (dhe bazuar në intervistat telefonike me grupe të marginalizuara) kanë konfirmuar se pjesëmarrja është shumë e ulët. Gjithashtu, asnjë nga komunat nuk kanë arritur të sjellin shembuj kur lista e projekteve kapitale për tu zbatuar në komunë ka ndryshuar për shkak të nevojave/kërkesave të grupeve të marginalizuara/të cenueshme të vitit të kaluar.

**Tabela 15:** Disa karakteristika të dëgjimeve buxhetore të organizuara nga tetë komunat

Komuna	Numri për vit	Debat	Agjenda	Pjesëmarrësit	Pjesëmarrja e grupeve të marginalizuara vitin e kaluar	Kërkesat e zakonshme të qytetarëve	Lista e prioriteteve që ka ndryshuar për shkak të kërkesave të grupeve të marginalizuara vitin e kaluar
Istog	4	Po	Prezantimi i listës së projekteve kapitale	Më pak se 40	Të gjitha grupet e marginalizuara	Infrastruktura	Nuk ka shembuj
Kaçanik	2	Jo	Prezantimi i projektbuxhetit, Kryetari i Komunës	Maksimumi 20	Personat me nevoja të veçanta, gratë, të rinjtë, të moshuarit	Ndriçimi publik, furnizimi me ujë, rregullimi i	Nuk ka shembuj
Lipjan	10	Po	Prezantimi i projektbuxhetit në përgjithësi	Maksimumi 20	Jo	Asfaltimi, uji i pijshëm, ndriçimi publik	Nuk ka shembuj
Novobërdë	2	Jo	Projektbuxheti	Më pak se 20	Jo	Jo	Nuk ka shembuj
Podujevë	2	Jo	Prezantimi i projektbuxhetit	Më pak se 40	Jo	Asfaltimi, uji i pijshëm, kanalizimi	Nuk ka shembuj
Shtërpçë	2	Jo	Nuk ka prezantim të buxhetit, qytetarëve	Më pak se 20	Jo	Trotualet, furnizimi me ujë, ndriçimi publik	Nuk ka shembuj
Shtime	7	Jo	Prezantimi i projektbuxhetit	Më pak se 20	Jo	Trotualet, ndriçimi publik	Nuk ka shembuj
Vushtri	6	Po	Prezantimi i projektbuxhetit	Më pak se 20	Jo	Trotualet, infrastruktura, ndriçimi publik dhe	Nuk ka shembuj

Aspekti i dëgjimeve buxhetore, që do të thotë organizimi i tyre siç duhet nga faza fillestare deri në mbajtjen e tyre në planifikimin e politikave nga komuna, duhet të adresohet në baza thelbësore. Në njërin anë, komunat i organizojnë ato për të bërë me shenjë që e kanë kryer, kurse në anën tjetër qytetarët nuk kanë besim në organizata të tilla dhe si pasojë nuk marrin pjesë. Për më tepër, nuk ekziston një zinxhir shkak-pasojë - ku qytetarët i shohin inputet e tyre (si shkaqe) dhe komunat reagojnë mbi këto efekte të inputeve. Një zinxhir i tillë nuk është vërejtur në asnjë prej komunave të vizituara. Në këtë kornizë, grupet e marginalizuara, pjesëmarrja e tyre, nuk është shqetësim për komunat dhe nuk ka asnjë politikë zyrtare (në asnjë nga komunat) për zhvillim dhe proces inkluziv dhe gjithëpërfshirës, ku grupet e marginalizuara/të cenueshme thonë fjalën e tyre.

# Zbatimi i buxhetimit të përgjegjshëm gjinor nga komunat dhe mënyra si e bëjnë atë

Buxheti i Përgjegjshëm Gjinor (BPGj) zbatohet nga komunat deri në masën që kërkohet nga Ministria e Financave përmes qarkoreve buxhetore.<sup>25</sup> Bazuar në një dokument të tillë të lëshuar nga Ministria e Financave në vitin 2019 për të gjitha organizatat buxhetore, për përgatitjen e buxhetit për vitin 2020, buxheti duhet të përgatitet sipas BPGj-së, siç përcaktohet nga Ligji për Barazinë Gjinore. Sipas këtij ligji, me qëllim të eliminimit të diskriminimit gjinor si dhe arritjes së barazisë gjinore, institucionet publike të të gjitha niveleve janë përgjegjëse për të zbatuar masat legislative dhe masat tjera duke përfshirë, “përfshirjen e buxhetimit gjinor në të gjitha fushat, si një instrument i nevojshëm për të garantuar që parimi i barazisë gjinore të respektohet në mbledhjen, shpërndarjen dhe caktimin e burimeve”.<sup>26</sup>

Sipas bisedimeve të zhvilluara me zyrtarët komunal, duke përfshirë zyrtarë nga drejtoria e buxhetit dhe ata për barazi gjinore, BPGj-ja zbatohet nga komunat dhe reflektohet në tre aspekte: 1) numri aktual i stafit në komunë dhe ata të planifikuar për vitin e ardhshëm, të ndarë sipas gjinisë, 2) pagat dhe mëditjet gjithsej, të ndara sipas gjinisë, 3) planifikimi i pagave për vitin e ardhshëm (për shembull në vitin 2019 për vitin 2020) të ndara sipas kategorive/nivelet e pagave të ndarë sipas gjinisë dhe 4) buxheti i shpenzuar dhe i planifikuar të shpenzohet përmes subvencioneve të ndara sipas gjinisë dhe numrit të përfituesve të ndarë në burra dhe gra. Sipas diskutimeve me komuna, janë përgatitur tre tabela standarde për të paraqitur të dhënat e lartpërmendura dhe ato i dorëzohen Ministrisë së Financave dy herë në vit, në mes të vitit kur përgatitet Korniza Buxhetore Afatmesme dhe më së voni në fund të shtatorit, për buxhetin e vitit të ardhshëm.

Në anën tjetër, përveç kërkesës së Ministrisë së Financave, planifikimi dhe ekzekutimi i buxhetit të komunës për qëllime të lidhura me gjininë është shpërndarë midis disa drejtorive dhe Zyrës së Kryetarit të Komunës. Kjo për arsye se projekt propozimi që ka të bëjë me gratë mund të mbështetet nga çdo linjë buxhetore e mundshme. Për shembull, nëse një projekt propozim ka të bëjë me gratë, mirëpo kanalizohet përmes Drejtorisë së Shëndetësisë (për shkak të llojit të kërkesës), buxheti i cili mbështet këtë propozim mund të gjendet në atë drejtori, dhe më pas të regjistrohet në sistemin e kontabilitetit të po asaj drejtorie. Pastaj, pasi të kryhen të gjitha shpenzimet në projektet që lidhen me gjininë nga drejtori të ndryshme dhe

25 Ministria e Financave, Qarkorja e Buxhetit (shih një shembull): <https://bit.ly/2P9IXvn>

26 Ligji Nr. 05/-020 për Barazinë Gjinore, neni 5, paragrafi 1.5: <https://bit.ly/2KsRtXT>

Zyra e Kryetarit të Komunës, i takon Drejtorit për Buxhet dhe Finance ose Zyrtarit Kryesor Financiar rasti i Shtimes) që së pari t'i mbledhë këto të dhëna, dhe pastaj t'i ndajë ato sipas shablloneve të Ministrisë së Financave.

Nga komunat e vizituara dhe zyrtarët për barazi gjinore që kemi takuar, asnjë prej tyre nuk ka zyrë të veçantë për barazi gjinore përveç një punonjësi për barazi gjinore që i përket Zyrës së Kryetarit të Komunës. Në rastin e Vushtrrisë, ka dy zyrtarë të tillë që merren me barazinë gjinore. Kur bëhet fjalë për linja të ndara buxhetore për barazinë gjinore, asnjë nga këta zyrtarë nuk ka deklaruar të ketë një linjë të veçantë buxhetore përmes së cilës trajtohen dhe mbështeten programe në lidhje me gjininë. Bazuar në leximin e buxhetit për vitin 2020, 15 nga 38 komuna kanë një nënprogram të quajtur “Çështjet Gjinore” që futet nën Zyrën e Kryetarit të Komunës. Nga komunat e vizituara dhe që i nënshtrohen këtij raporti, vetëm komuna e Istogut, Vushtrrisë dhe Novobërdës kanë një nënprogram të tillë të themeluar në kuadër të Zyrës së Kryetarit të Komunës dhe në vijim jepen disa të dhëna të pakta sa i përket kategorizimit të këtij buxheti. Tabela në vijim shfaq buxhetin sipas nënprogramit “Çështjet Gjinore” në tri komuna.

**Tabela 16:** Nënprogrami “Çështjet Gjinore” në komunat: Istog, Vushtri dhe Novobërdë

Komuna	Nënprogrami	Stafi i punësuar	Pagat/mëditjet	Mallrat dhe shërbimet	Subvencionet dhe transferet
Istog	Çështjet gjinore	1	7,300 euro	5,000 euro	2,000 euro
Vushtri	Çështjet gjinore	2	11,789 euro	3,000 euro	N/A
Novobërdë	Çështjet gjinore	1	7,200 euro	2,000 euro	N/A

Burimi: Buxheti për vitin 2020

Siç mund të shihet nga tabela e mësipërme, roli i zyrtarëve për barazi gjinore në aspekt të mbështetjes së programeve të lidhura me gjininë është i vogël, ndonëse jo inekzistent. Nga të tre komunat, vetëm komuna e Istogut ka një buxhet të vogël në kategorinë e subvencioneve dhe transfereve, të cilat mund të përdoren për çdo aktivitet apo projekt që lidhet me gratë. Dy komunat e tjera shpenzojnë për pagat e tyre në bazë vjetore dhe mallra dhe shërbime.

Gjithashtu, për në pasqyrë më të qartë mbi atë se si BPGj-ja planifikohet dhe ekzekutohet në shabllone sipas kërkesave të MF-së, nga ana e të gjitha komunave, shih shembullin në vijim. Të dhënat janë reale, megjithatë, emri i komunës nuk tregohet në tabela, pasi që dokumenti i bazuar në të cilin janë paraqitur tabelat e mëposhtme është i brendshëm dhe për qëllime të komunës.

**Tabela 17: Planifikimi dhe ekzekutimi i Buxhetimit të Përgjegjshëm Gjinnor në komuna****Tabela 17.1: Numri i stafit në komunën X i ndarë sipas gjinisë**

Viti	Gjithsej stafi	Gratë	Burrat	Pagat (mëditjet) për gratë	Pagat (mëditjet) për burrat
2018	650	274	386	1,684,139.52	2,305,924.48
2019	665	274	386	1,684,139.52	2,305,924.48
2020	665	256	409	1,824,052.00	2,953,728.00
Planifikimi për 2021	665	329	337	2,124,905.38	2,235,998.62

**Tabela 17.2: Nivelet/kategoritë e pagave për vitin 2020 në komunën X, të ndarë sipas gjinisë**

Nivelet e pagave	Stafi që i përket nivelit	Burra	Buxheti i shpenzuar për burrat	Gra	Buxheti i shpenzuar për gratë
201 – 400 euro	112	66	419,494.66	46	254,714.20
401 – 600 euro	482	231	1,453,569.12	251	1,617,695.01
600 + euro	71	41	358,956.00	30	256,475.00
Gjithsej	665	338	2,232,020	327	2,128,884

**Tabela 17.3: Numri i përfituesve nga subvencionet që u përkasin drejtorive të ndryshme (kur është e zbatueshme)**

Viti	Buxheti për subvencione	Gjithsej përfituesit	Gratë përfituese	Burrat përfitues	Buxheti për gratë	Buxheti për burrat
2019	131,766	90	51	39	67,200	64,565
2020	150,000	105	61	44	87,000	63,000
Planifikimi për 2021	150,000	85	55	30	97,500	52,500



# Pjesëmarrja e qytetarëve në proceset e politikbërjes dhe vendimmarrjes në komuna

Pjesëmarrja e qytetarëve në proceset e politikbërjes dhe vendimmarrjes në komunat përkatëse është vlerësuar si shumë e ulët nga përfaqësuesit e OJQ-ve të takuar për këtë qëllim. Gjithashtu, kjo pjesëmarrje është ekskluzive vetëm për takimet publike dhe dëgjimet buxhetore të cilat janë të detyrueshme për komunën që do të organizohet. Në rastin e Istogut, OJQ-të si “Vision 02”<sup>27</sup> dhe “ABA”<sup>28</sup> theksojnë se ata herë ftohen, e herë jo, përmes mediave sociale të komunës dhe pjesëmarrja e tyre është e rrallë. Gjithashtu, sipas tyre, qytetarët marrin pjesë në një numër shumë të vogël në këto ngjarje dhe që mund të përketet si shumë e ulët. E njëjta tendencë përsëritet nga OJQ “Qendra Rinore e Kaçanikut”<sup>29</sup> dhe shumica e ndërveprimit ndërmjet komunës dhe qytetarëve varet nga kërkesat/kontaktet individuale të qytetarëve me komunën.

Në rastin e Lipjanit, përfaqësuesi i OJQ-së Polis<sup>30</sup> thotë se qytetarët marrin pjesë në takime publike, megjithëse, pjesëmarrja e tyre është shumë e ulët dhe pjesëmarrësit janë persona të lidhur me qeverinë lokale. Në rastin e Novobërdës, përfaqësuesi i OJQ-së Kalaja<sup>31</sup> thotë se qytetarët nuk ftohen të marrin pjesë në dëgjime buxhetore, e as OJQ-ja Kalaja nuk është e ftuar të bëjë një gjë të tillë. Trendi i njëjtë është përsëritur nga OJQ-të lokale në komunat e Podujevës (OJQ Sundimi i Demokracisë<sup>32</sup>), komunën e Shtërpçës nga OJQ lokale DEA<sup>33</sup>, në komunën e Shtimes nga OJQ lokale “Qendra Rinore” dhe në rastin e Vushtrrisë përsëritet nga OJQ lokale “Fodem”<sup>34</sup> atje.

27 Takimi me Regj Malaj, OJQ Vision 02, 5 nëntor 2020, Istog.

28 Intervistë përmes telefonit me Kreun e OJQ, 7 nëntor 2020.

29 Takimi me Bafti Dogani, 15 nëntor 2020, Prishtinë.

30 Takimi me Muhamet Qeriqi, 19 nëntor, Lipjan.

31 Takimi me Sami Vllasaliu, 16 nëntor, Novobërdë.

32 Intervistë përmes telefonit me Rexhep Zeka, 25 nëntor 2020.

33 Intervistë përmes telefonit me Betim Musliu, 26 nëntor 2020.

34 Takimi me Xhavit Mehmeti, 12 nëntor 2020.

# Rekomandimet

- 1.** Komunat duhet të bëjnë më shumë në mënyrë që ta dinë situatën e grupeve të marginalizuara/të cenueshme që jetojnë brenda në komunë. Në këtë drejtim, komunat duhet të bëjnë hartëzimin e shqetësimeve të grupeve të marginalizuara/të cenueshme dhe kështu të kenë një pasqyrë të qartë për nevojat dhe kërkesat e grupeve të tilla. DEMOS-i duhet të merr parasysh mbështetjen e një numri të përzgjedhur të komunave, të cilat shërbejnë si projekt pilot, dhe nëse vërtetohet të jetë i suksesshëm, të ndjekë modelin për komunat e tjera.
- 2.** Sipas kësaj kornize dhe gjithmonë bazuar në situatën me grupe të marginalizuara/të cenueshme që vijnë nga hartëzimi i përmendur më lartë, komunat duhet të identifikojnë ndonjë grup të marginalizuar/të cenueshëm ku nevojiten burime/projekte shtesë. Kjo më tej hap rrugën për një mbështetje dhe ndihmë edhe më konkrete në lidhje me përmirësimin e jetës së grupeve të marginalizuara. DEMOS-i duhet të konsiderojë mbështetjen e komunave edhe në këtë drejtim.
- 3.** Komunat me mbështetjen e DEMOS-it duhet logjikisht të vazhdojnë me hartimin e vizioneve dhe programeve/planeve (shumëvjeçare) për avancimin e grupeve të marginalizuara/të cenueshme që jetojnë në komuna. Plani duhet të jetë i orientuar drejt qëndrueshmërisë së rezultateve/projekteve të viteve paraprake, në mënyrë që të mos bjerë në një cikël mbështetjeje të asaj që vjen e para dhe në varësi të gjykimit dhe kriterëve ad-hoc.
- 4.** DEMOS-i mund të mbështesë komunat për të organizuar ngjarje më të mëdha me donatorë të mundshëm në Kosovë ku prezantohen dokumentet e lartpërmendura dhe diskutimet mbi financimin e mundshëm të projekteve konkrete. Dokumente të tilla (si më sipër) do të ndihmojnë çdo donator të mundshëm të dinë se çfarë dhe ku mund të mbështesin financiarisht. Në këtë drejtim, komunat së pari duhet të bëjnë punën e tyre.
- 5.** DEMOS-i duhet të marrë në konsideratë se si mund të sigurojë stimuj për komunat të cilat propozojnë projekte kapitale të financim përmes GPK-së, ku përfituesit e drejtpërdrejtë të projektit janë grupe të marginalizuara/të cenueshme. Kjo do të thotë që komunat mund të marrin pak më shumë fonde me kusht që projekti i propozuar të jetë i lidhur drejtpërdrejtë me nevojat dhe kërkesat e grupeve të marginalizuara/të cenueshme. Nevojitet zhvillimi i një formule këtu nga DEMOS-i, si plotësim për mënyrën sesi bëhet MPS-ja sot.
- 6.** DEMOS-i duhet të mbështesë komunat për të bërë përpjekje të veçanta për të arritur tek grupet e marginalizuara/të cenueshme gjatë planifikimit të projekteve kapitale që do të zbatohen vitin e ardhshëm.
- 7.** DEMOS-i duhet të mbështesë komunat për të klasifikuar dhe regjistruar buxhetin bazuar në programe sipas grupeve të marginalizuara, qoftë si një kategori ose grup kategorish/programesh nën një kryesore. Në këtë aspekt, duhet të sigurohet mbështetje e mëtejshme për të alokuar buxhetin për subvencione/transfere përmes të cilave mund të mbështeten projekte/aktivitete të komunës ose grupe të marginalizuara/të cenueshme.

8. Situata me krijimin e Zyrove për Komunitete dhe Kthim është më e mirë në krahasim me krijimin e Zyrove për Barazi Gjinore. DEMOS-i mund të përfshihet në bashkëpunim me Agjencinë për Barazi Gjinore në kuadër të ZKM-së analizuarën analizimin e mbështetjes së ardhshme për këtë proces. Në anën tjetër, edhe në vendet ku ekzistojnë Zyra për Komunitete dhe Kthim, buxheti në dispozicion për ta është shumë i ulët, dhe shpeshherë edhe inekzistent në kategorinë e subvencioneve/transfereve. Në këtë mënyrë, këto zyre kufizohen në mbështetjen e komuniteteve ose grave në çfarëdo projekti për avancimin e të drejtave dhe përfitimeve të tyre.
9. Komunitat nuk e zbatojnë BPGj-në sipas kuptimit të saj. Ajo zbatohet në masën që kuptohet nga Ministria e Financave. Bërja e këtij ndryshimi është një përpjekje e madhe dhe DEMOS-i duhet të analizojë se si mund të mbështesë komunitat për këtë, gjithmonë në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe ekspertë të tjerë në lidhje me BPGj-në dhe buxhetin në përgjithësi.
10. DEMOS-i duhet të konsiderojë qëndrimin më pranë komunave për të ndjekur nëse projekti i financuar përmes GPK-së është finalizuar me kohë, nëse po ai projekt zbatohet siç është propozuar dhe nëse komuna po alokon burime shtesë për të mirëmbajtur projektin dhe për ta bërë atë të prodhojë efektet e tij më të mira (siç ishte planifikuar fillimisht). Kjo sepse projektet e vizituara të financuara nga GPK-ja mund të mos mbështeten nëse komuna nuk alokon burime shtesë njerëzore dhe financiare për ta bërë projektin funksional/të qëndrueshëm dhe përfitues (të vazhdueshëm) për qytetarët.
11. Dëgjimet buxhetore kanë ardhur në atë fazë sa nuk perceptohen më si të frytshme as nga komuna e as nga qytetarët. Duhet të analizohen dhe të gjenden mënyrat inovative për të rritur nivelin e pjesëmarrjes së qytetarëve në dëgjimet buxhetore. Nga ana tjetër, komunitat duhet të hartojnë një agjendë të këtyre dëgjimeve buxhetore për të qenë fillimisht serioze me pjesëmarrësit. Nëse komuna së paku nuk paraqet një projekt buxhet, por pret nga qytetarët të angazhohen në debat pa pasur informatat e duhura, kjo do të thotë që komuna nuk është serioze në organizimin e ngjarjeve të tilla.
12. Po kështu, pjesëmarrja e qytetarëve në proceset e politikbërjes dhe vendimmarrjes në komunë duhet të rimendohet dhe proceset e reja duhet të projektohen për të mirën e të dy palëve, d.m.th komunës dhe qytetarëve. Zyrtarizmi i takimeve publike ka arritur në atë pikë sa që forma të tjera të ndërveprimit midis qytetarëve dhe komunave duhet të merren parasysh seriozisht.



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development  
and Cooperation SDC



Sweden  
Sverige



Norwegian Embassy  
Prishtina



**HELVETAS**  
KOSOVO